



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. ____ / ____ Prot.
____ / ____ / 2018

Tiranë, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **EUROMED shpk me NIPT K71718012P**, adresë: Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastati", përfaqësues me prokurë të posaçme i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë **O.E.S DISTRIMED shpk. me NIPT K31520054N** Adresë: Tiranë, "Dervish Hima" 3 kullat K.3 AP 9/2 dhe **EUROMED shpk me NIPT K71718012P** Adresë Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, Pranë Marternitetit të ri.

* * *

Procedura e prokurimit: e hapur, me mjete elektronike, mallra, Ref: **45212-02-08-2018**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "MM3- Materiale mjekimi për anestezi reanimacion, shiringa dhe age, njëpërdorimshme kirurgjikale"- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj) ”.

Fondi limit i marrëveshjes kuadër: **40,667 (dyzet mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH**, ku fondi limit nënkupton totalin e çmimeve të përlllogaritura për njësi për çdo artikull, referuar pikës 7.3 të Udhëzimit nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total): 181,501,982 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të tenderit: 12.03.2018

Kohëzgjatja e kontratës: **12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, ofertad dekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- **Bylis Pharma pa ofertë**
- **Bashkimi i OE “MEDFAU” shpk, me NIPT J93610823R dhe “FEDOS” me NIPT K01514009I me përfaqësues shoqërinë MEDFAU shpk me ofertën me vlerë për njësi për cdo artikull 28,639 (njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 152,143,485 (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e njëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.**
- **Montal shpk pa ofertë.**
- **Bashkimi i operatoreve: O.E.S DISTRIMED shpk. me NIPT K31520054N dhe EUROMED Sh.p.k me NIPT K71718012P, me përfaqësues EUROMED Shpk me ofertën me vlerë për njësi për cdo artikull 31,901.40 (tridhjetë e një mijë e nëntëqind e një pikë dyzetë) lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 175,100,034 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e njëqind mijë e tridhjetë e katër) Lekë.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- **Bylis Pharma pa ofertë**
- **Bashkimi i OE “MEDFAU” shpk, me NIPT J93610823R dhe “FEDOS” me NIPT K01514009I me pëfaqësues shoqërinë MEDFAU shpk me ofertën me vlerë për njësi për cdo artikull 28,639 (njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 152,143,485 (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e njëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.**
- **Montal shpk pa ofertë.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Shoqëritë **Bylis Pharma Shpk, Montal Shpk**, nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. Gjithashtu keto shoqëri nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike.

dhe **BOE i OE “MEDFAU” shpk dhe “FEDOS” shpk per:**

I. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, në pikën nr. 9, është kërkuar të paraqitet: *“Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike, janë paraqitur dokumente me emërtimin Katalog dhe katalogje ku përcaktohen përmes emërimit të artikullit përkatës, nga verifikimi i të cilit konstatohet se këto dokumenta janë në gjuhë të huaj. Kjo vjen në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: *“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”*, gjithashtu edhe në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: *“Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër _____”*

Sa më sipër konstatohet se katalogët e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj.), por përmban edhe karakteristika teknike të shprehura e shpjeguara me përshkrim.

Përcaktimi i bërë në dokumentat e tenderit, si në seksionin IV, ashtu edhe në Shtojcën 9 Kriteret e veçanta të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

II. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, në pikën 9, është përcaktuar: *“Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas*

numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në eëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)”.

Bashkimi i operatorëve ekonomik për këta Artikuj 1, 2, 3, 4, 5,9 ,10, 11, 12, 14, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36 që i përkasin kategorisë “Materiale mjekimi për Anestezi - reanimacion” Artikujt 7, 8, 9, 10, 11 dhe 16 në kategorinë “Shiringa dhe Age”, artikujt 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11 dhe 12 në kategorinë “Materiale nje perdorimeshe per kirurgji”, nuk i ka markuar si dhe nuk ju ka vendosur numër rendor, kjo vjen në kundërshtim me kriterin e pikës 9 të përcaktuara në DST.

III. Per artikullin 3 “Age spinale e zakonshme” dhe artikullin 4 “Age spinale atraumatike” eshte paraqitur vetem examination design CE por jo Certifikata CE, në kundërshtim me Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”* dhe Shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, nr. 6, ku përcaktohet: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuara”*

IV. Për artikullin 30 në kategorinë “Materiale mjekimi për Anestezi - reanimacion”, nuk ka paraqitur katalog të kompanisë prodhuese Elite Medical (Nanjig) Co.,Ltd. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3. “Kapaciteti teknik”, nr. 9 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DST, *ku kërkohet të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar, e konkretisht Bashkimi i OE nuk ka ngarkuar katalog teknikë përkatës për këtë artikull.*

V. Për autorizimin e paraqitur për kompaninë prodhuese “Wellmed International Industries Pvt. Ltd. Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur autorizim të përkthyer dhe noterizuar nga kompania prodhuese për tregëtimin e artikujve të ofruar por ka ngarkuar vetëm autorizimin origjinal i cili është në gjuhë të huaj. Konkretisht në dokumentat e tenderit Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, pikën 7, është përcaktuar: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese për tregëtimin e artikujve të ofruar. (të përkthyer dhe të noterizuar).*

VI. Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës të ngarkuar nga bashkimi i OE rezulton se autorizimi i kompanisë prodhuese “Yangzhou Super Union Import & Export Co., Ltd” është lëshuar për shoqërinë MEDFAU shpk, ndërsa në formularin e ofertës të kësaj procedure si dhe në Marrëveshjen e bashkëpunimit të shoqërisë Medfau dhe Fedos, të përpiluar nga Noteri Gjergj Kongoli, me nr. 1353 rep, nr. 487 kol, rezulton se artikujt e kompanisë prodhuese “Yangzhou Super Union Import & Export Co., Ltd”, janë deklaruar se do të ofertohej nga pjestari i BOE FEDOS shpk.

VII. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik nuk përmbush kriteret e kërkuara në pikën 4, *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001 ose ISO 13485, të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, të përkthyer dhe të noterizuar”,* pikën 6 *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, të vlefshme, për*

të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuara”, pikën 7 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese për tregëtimin e artikujve të ofruar. (të përkthyer dhe të noterizuar”) dhe pikën 9 “Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për artikujt 6,18,25,13, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Konkretisht nuk janë paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon

- Për artikullin 6 “Kateter zgjatues venoz” në të cilën është deklaruar në formularin e ofertës se do të sillet nga FEDOS me prodhues “M/S. SURU INTERNATIONAL PVT.LTD.” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion (autorizim, ISO, CE, Katalog) të kompanisë prodhuese.
- Për artikullin 18 “Age spinale pediatrike” në të cilën është deklaruar në formularin e ofertës se do të sillet nga FEDOS me prodhues “TMT Ttbbi Medikal Malzemert San. ve Tic. ltd. li.” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion (autorizim, ISO, CE, Katalog) të kompanisë prodhuese.
- Për artikullin 25 “Age aspirimi” në të cilën është deklaruar në formularin e ofertës se do të sillet nga FEDOS me prodhues “BIOPSYBELL S.R.L.” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion (autorizim, ISO, CE, Katalog) të kompanisë prodhuese.
- Për artikullin 13 “Beze me vazeline” në të cilën është deklaruar në formularin e ofertës se do të sillet nga FEDOS me prodhues “Tairee Medical Products Co., Ltd.” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion (autorizim, ISO, CE, Katalog) të kompanisë prodhuese.

VIII. Në certifikatën ISO të kompanisë prodhuese “Hospital & Homecare IMP. & EXP. Co., LTD. Nanjing” nuk është e shkruajtur certifikimi për age, dhe rrjedhimisht për artikujt 7, 8, 9, 10 dhe 11 të kategorië “Shiringa dhe age”, këto artikuj nuk janë të certifikuar me certifikatën CE në kundërshtim me Shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, kriterin e pikës 6, ku përcaktohet “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuara, si dhe me Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme””.

IX. Për artikullin 22 “Gjuheza për laringoskop me kamera”, bashkimi i OE nuk plotëson specifikimet teknike, sepse ky artikull nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST konkretisht Gjuhëz për laringoskop me kamera me material polimer optik, sipas katalogut specifikimet teknike Gjuheza për laringoskop me kamera me material antifog. Pra është në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se : “Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.”

Gjithashtu edhe nga verifikimi i monstrave të këtij artikulli nga komisioni u konstatua se

gjuhëza nuk ishte e paketuar dhe sterile, si dhe gjuhëza e dorëzuar në mostër nuk përputhet me gjuhëzat e paraqitura në katalog. Pra është në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se: *“Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës”* si dhe në kundërshtim me Shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, pikën 10, ku përcaktohet: *“Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës2018, ora ____ : ____.*

- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*

- *Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).*

- *Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).*

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.”

X. Per artikullin 32 “Sonde blakemore”, sipas specifikimeve në DST sonde blakemore është kerkuar me nr 16 dhe nr.20, nga verifikimi i katalogut të kompanisë prodhuese rezultoi se kjo kompani nuk përmban nr. 20, në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se: *“Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës”,* si dhe Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.*

XI. Për artikullin 33 “Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis” nuk plotëson specifikimet teknike, sepse sipas specifikimeve teknike në DST është kerkuar që sfungjeri nazal të jetë me kompresim të dyfishtë, pa fibra, me absorbim të lartë, hemostatik dhe biokompatibel. Referuar katalogut të paraqitur rezultoi se ky artikull nuk është konform specifikimeve teknike të kerkuara por është vetëm me absorbim të lartë dhe hemostatik.

Pra është në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se: *“Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.”,* si dhe Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.*

XII. Për artikullin 34 “Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi” nuk plotëson specifikimet teknike, sepse sipas specifikimeve teknike në DST është kerkuar që Sfungjeri Nazal pa fill me tub ajrimi të jetë me kompresim të dyfishtë, pa fibra, me absorbim të lartë, hemostatik dhe biokompatibel.

Produkti I ofruar nga operatorët ekonomik është me fill (with string& Tube). Pra është në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se :*“Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.”*, si dhe Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

XIII. Për artikullin 35 “Sfungjer Nazal me fill” nuk ploteson specifikimet teknike, sepse sipas specifikimeve teknike në DST është kërkuar që Sfungjeri Nazal me fill të jete me kompresim të dyfishtë, pa fibra, me absorbim të lartë, hemostatik dhe biokompatibel.

Specifikimi teknik i paraqitur është nuk është konform specifikimeve teknike të kërkuara por është vetëm me absorbim të lartë dhe hemostatik.

Pra është në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se :*“Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.”*, si dhe Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

XIV. Për artikujt 8 “Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm” dhe 14 “Beze hidroxhel” nga kompania prodhuese (e deklaruar) “Lohmann & Rauscher International dhe GmbH & Co. KG” është paraqitur katalog i markuar me nr. tjetër dhe specifikimet nuk i perkasin produktit të kërkuar por është një artikulli tjetër që nuk përputhet me artikullin e kërkuar në DST. Gjithashtu nuk ekziston katalog tjetër që ti përgjigjet këtyre dy artikujve, kjo vjen në kundërshtim me Shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, kriteri i kërkuar në pikën 9, ku është përcaktuar: *“Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)”*.

XV. Për artikullin 3, “Maskë kirurgjikale”, nuk ploteson specifikimet teknike, sepse sipas specifikimeve teknike në DST është kërkuar që maska kirurgjikale të jete me lidhese, konkretisht nga verifikimi i mostrave dhe katalogut rezulton se maskat janë me llastik dhe jo me lidhese sic janë ketkua. Pra është në kundërshtim me shtojcën 10, Specifikimet teknike, ku përcaktohet se :*“Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.”*, si dhe Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **EUROMED shpk me NIPT K71718012P** adresë: Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastati", përfaqësues me prokurë

të posaçme i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, **O.E.S DISTRIMED shpk.** me NIPT K31520054N dhe **EUROMED shpk** me NIPT K71718012P se oferta e paraqitur me vlerë në total për njësi cdo artikull 31,901.40 (tridhjetë e një mijë e nëntëqind e një pikë dyzetë) lekë pa TVSH, me vlerë të pritshme në total pa TVSH 175,100,034 (njqind e shtatëdhjetë e pesë milion e njëqind mijë e tridhjetë e katër) Lekë., pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [autoritetit kontraktor përfitues] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brënda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.04.2018

Ankesa: Jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

